

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Supreme e Kosovës – kolegji i përbërë nga gjyqtaret : Avdi Dinaj kryetar, Emine Mustafa dhe Nebojsa Boriçiq, anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Minire Xhambazi, procesmbajtëse, në çështjen penale kundër të dënuarit Sh. F. nga Kukësi Republika e Shqipërisë, për shkak të veprës penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve të rrezikshëm dhe substancave psikotrope nga neni 273 par. 2 lidhur me par. 1 lidhur me nenin 281 par. 1 nënpar. 1.1 dhe 1.9 të KPK, duke vendosur sipas kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë, të paraqitur nga mbrojtësi i të dënuarit Sh. F., paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore – Departamenti për Krime të Rënda Prishtinë PKR. nr. 342/2014 datë 12.11.2015, dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës – Departamenti për Krime të Rënda PAKR. nr. 09/2016 datë 04.02.2016, në senenë e kolegjit të mbajtur më 14 qershor 2016 mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e mbrojtësit të të dënuarit Sh. F., paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore – Departamenti për Krime të Rënda Prishtinë PKR. nr. 342/2014 datë 12.11.2015, dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës – Departamenti për Krime të Rënda PAKR. nr. 09/2016 datë 04.02.2016.

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore- Departamenti për Krime të Rënda Prishtinë PKR .nr. 342/2014 datë 12.11.2015, i dënuari Sh. F., është shpallur fajtor për shkak të veprës

penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve të rrezikshëm dhe substancave psikotrope nga neni 273 par. 2 lidhur me par. 1 lidhur me nenin 281 par. 1 nën par. 1.1 dhe 1.9 të KPK dhe për këtë veprë është gjykuar me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 4 (katër) vitesh, në të cilën dënim i është llogaritur edhe koha e kaluar në paraburgim nga data 27.03.2014 gjerë më 12.11.2015, dhe me dënim me gjobë në shumë prej 4.000 € (katërmijë euro), të cilin dënim është i obliguar që të paguaj në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit, në të kundërtën ky dënim do të zëvendësohet me dënim burgimi, ashtu që për çdo 20 € do t'i llogaritet një ditë burgim. Është shqiptuar edhe dënimi plotësues konfiskimi i të hollave në vlerë prej 17.600 lek shqiptare, 75 € dhe një zinxhir i arit. Është detyruar që në emër të shpenzimeve të procedurës penale të paguaj shumën sipas regjistrit të shpenzimeve, ndërsa në emër të paushallit gjyqësor shumën prej 100 €, të gjitha në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Duke vendosur sipas ankesës, Gjykata e Apelit të Kosovës, me aktgjykimin e saj PAKR.nr. 09/2016 datë 04.02.2016, me aprovimin e ankesës të mbrojtësit së të dënuarit ka vendosur si në vijim :

“ I. Me aprovimin e ankesës së mbrojtësit të akuzuarit Sh. F., NDRYSHOHET aktgjykimi i Gjykatës Themelore – DKR në Prishtinë PKR .nr. 342/2014 datë 12.11.2015, vetëm sa i përket vendimit mbi dënimin, ashtu që Gjykata e Apelit, të akuzuarin Sh. F., për veprën penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve të rrezikshëm dhe substancave psikotrope, nga neni 273 par. 2 lidhur me nenin 281 par. 1 nën par. 1.1 dhe 1.9 të KPRK, më hollësisht të përshkruar në dispozitiv të aktgjykimit e gjykon me dënim me gjobë në shumë prej 2.500 (dymijë e pesëqind)€, dhe me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 3 (tre) vite e 2 (dy) muaj, në të cilin dënim i llogaritet koha e kaluar në paraburgim prej datës 27.03.2014 e këndej.

II. Në pjesën tjetër aktgjykimi mbetet i pa prekur.”

Kundër këtyre aktgjykimeve, kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë ka paraqitur mbrojtësi i të dënuarit Sh. F., M. S., avokat nga Prishtina për shkak të shkeljes së ligjit penal me propozim që aktgjykimet e kundërshtuar të ndryshohen ashtu që të dënuarit t'i shqiptohet një dënim dukshëm më i butë.

Prokurori i Shtetit të Kosovës, me parashtresën KMLP .II. nr. 94/2016 datë 03.06.2016, ka dhënë përgjigje në kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë, duke propozuar që e njëjta të refuzohet si e pabazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës, në seancën e kolegjit shqyrtoi të gjitha shkresat e çështjes në kuptim me dispozitën e nenit 435 par. 1 dhe 436 par. 1 të KPPK, dhe pas vlerësimit të pretendimeve nga kërkesa ka gjetur se:

Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë nuk është e bazuar.

Në kërkesë, mbrojtësi i të dënuarit thekson se të dy gjykatat me aktgjykimet e tyre kanë bërë shkeljet e ligjit penal në dëm të dënuarit respektivisht janë shkelur dispozitat e nenit 75 dhe 76 dhe KPK, dhe si pasoj e kësaj shkelje të dënuarit i është shqiptuar dënimi tepër i rëndë. Më pas potencohet se gjykata e shkallës së dytë e ka vlerësuar si rrethanë veçanërisht lehtësuese rrethanën se i dënuari është penduar për veprën e tij, rrethanë kjo e cila tregon se qëllimi i dënimit mund të arrihet edhe me dënimin me të butë. Theksohet se duke pasur parasysh se kontributi i të dënuarit Sh. në raport me të dënuarit të tjerë si bashkëkryerës ka qenë shumë i vogël, pastaj duke pasur parasysh faktin se i dënuari e ka pranuar fajsin dhe se është penduar thellë për veprimet e tij, janë plotësuar kushtet që të aplikohet dispozita e nenit 76 të KPK dhe ti shqiptohet një dënim më i butë.

Si që rezulton nga shkresat e çështjes, i dënuari Sh. F., është shpallur fajtor për shkak të veprës penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve të rrezikshëm dhe substancave psikotrope nga neni 273 par. 2 lidhur me par. 1 lidhur me nenin 281 par. 1 nën par. 1.1 dhe 1.9 të KPK, dhe për këtë veprë nga gjykata e shkallës së parë i është përcaktuar dënimi me burgim në kohëzgjatje prej 4 (katër) vitesh dhe dënim me gjobë në shumë prej 4.000€.

Gjykata e shkallës së dytë, ka ndryshuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, përkritazi me vendimin për dënimin dhe për këtë veprë të dënuarit i ka përcaktuar dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 3 (tre) vite e 2 (dy) muaj si dhe dënim me gjobë në shumë prej 2.500€.

Me rastin e matjes së dënimit, gjykata e shkallës së parë i ka vlerësuar të gjitha rrethanat e parapara nga neni 73 të KPK, ashtu që si rrethana lehtësues ka vlerësuar se i dënuar rrjedh nga një familje të varfër, me gjendje të dobët ekonomike, sjelljet e tij korrekte gjatë gjithë shqyrtimit gjyqësor si dhe moshën e ti relativisht të re ndërsa si rrethana rënduese gjykata ka vlerësuar rrezikshmërinë shoqërore e veprës së kryer penale, se veprën e ka kryer me dashje për përfitimin material si dhe faktin se veprat e këtilla penale janë në rritje e sipër.

Gjykata e shkallës së dytë rrethanat lehtësuese të vlerësuar nga gjykata e shkallës së parë i ka aprovuar kurse përkitazi rrethanat rëndues, ka gjetur se disa prej tyre përbëjnë elemente qenësore të veprës penale për të cilën i dënuari është shpallur fajtor dhe nuk mund të merren si të tilla prandaj ka ndryshuar vendimin e shkallës së parë përkitazi me sanksionin penale dhe të dënuarit i ka shqiptuar dënimin si në dispozitiv të aktgjykimit duke pritur se me një dënim të tillë mund të arrihet qëllimi i ndëshkimit i para par me ligj.

Dispozitat e nenit 73 të KPK parashikon rregullat e përgjithshme për matjen e dënimit ashtu që konform paragrafit 1 kësaj dispozite janë paraparë në mënyrë të përgjithësuar të cilat rrethana gjykata do t'i marrë parasysh gjatë matjes së dënimit dhe me atë rast i cekë rrethanat më tipike lehtësues dhe rënduese, duke ja lënë mundësin gjykatës që në çdo rast konkret të marrë parasysh edhe rrethanat tjera, të cilat ndikojnë që të shqiptoj dënimin me të rreptë apo me të butë. Në mesin e rrethanave që parashihen në paragrafin 1 gjenden rrethanat objektive që i referohen veprës penale dhe ato subjektive që referohen kryerësit. Rrethanat lehtësues dhe rënduese janë ato rrethana të cilat janë prezentë me rastin e kryerjes së veprës penale, por nuk janë elemente të saj, nuk hyn në figurën e saj.

Në rastin konkret, duke patur parasysh faktin se për veprën penale për të cilin i dënuari është shpallur fajtor nenin 281 është përcaktuar dënimi me burgim prej 3 deri në 15 vjet. Pra në këtë rast nuk ka dyshim se gjykata e shkallës së parë dhe ajo e shkallës së dytë duke ndryshuar aktgjykimin e shkallës së parë përkitazi me vendimin mbi sanksionin penal, përmes institutit të matjes së dënimit në kuptim të dispozitës së lartcekur ka bërë individualizimin e dënimit dhe ka shqiptuar dënimin e para par ligjor brenda kufijve të përcaktuar me ligj për këtë vepër penale, për çfarë gjykata e shkallës së dytë për uljen e dënimit ka dhënë arsye në faqen 4 të aktgjykimit, ku gjykata ka konstatuar të gjitha rrethanat të vlerësuar, lehtësuese sikurse edhe ato rënduese, mirëpo nga arsyetimi nuk rezulton se kjo gjykatë të ketë vlerësuar si rrethanë veçanërisht

lehtësuese pendimin e të dënuari për veprën e kryer siç potencohet në kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë, konkludimet këto të cilat si të drejta dhe të ligjshme e pranon edhe kjo gjykatë.

Për më tepër sipas dispozitës së nenit 75 dhe 76 të KPK, është paraparë që gjykata mund të zbusë dënimin nën kufirin e paraparë me ligj nën kushtet e parapara me këtë dispozitë, mirëpo kjo është vetëm një mundësi e jo normë imperative dhe është në diskrecion të gjykatës që varësisht nga rrethanat e rastit konkret të aplikoj dispozitën në fjalë, prandaj pretendimet nga kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë së në rastin konkret do të duhej të aplikoheshin dispozitat e përmendur del si i pabazuar.

Nga arsyet e lartcekura, kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë është refuzuar si e pabazuar dhe në pajtim me dispozitën e nenit 437 të KPPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS – PRISHTINË

Pml.nr. 133/2016 datë 14 qershor 2016

Procesmbajtësja,
Minire Xhambazi

Kryetar i kolegjit
Avdi Dinaj